

RAPORT I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

OBJEKTI:Rehabilitimi i kanalit ujitës të tokave bujqësore Sasaj-Lukovë-Shën Vasil.



R A P O R T

SHKURTER I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

OBJEKTI:Rehabilitimi i Rrjetit Ujites Sasaj-Lukove-Shen Vasil dhe Sasaj Piqeras

HYRJE

Me kerkese te Bashkise Himare, u hartua vleresimi i ndikimit ne mjedis te veprimtarise ndertuese gjate zbatimit te projektit.

Gjithe informacioni i pergatitur per vleresimin e ndikimit ne mjedis te firmes ne fjale eshte bazuar dhe merr ne konsiderate ligjin nr. 8934 dt. 05.09.2002 "Per Mbrojtjen e Mjedisit"; Ligjin Nr.8990 dt. 23.01.2003 "PerVleresimin e Ndikimit ne Mjedis", Ligjin nr.8897, dt. 16.05.2002 "Per Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja", Ligjin Nr.8405, dt. 17.09.1998 "Per Urbanistiken" Ligjin Nr.8906 dt. 06.06.2002 "Per Zonat e Mbrojtura", Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.453, dt.12.09.2002 "Per Miratimin e Normave te Shkarkimeve ne Ajer ne Republiken e Shqiperise", Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr.177, dt.31.03,2005 "Per Normat e Lejuara te Shkarkimeve te Lengeta dhe Kriteret e Zonimit te Mjediseve Ujore", Udhezimin Nr. 1 dt.15.03.2006 te dy ministrive, ajo e Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave si dhe e Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Materiali i pergatitur paraqet shkallen e ndikimit ne mjedis te veprimtarise qe do te kryhet si dhe masat qe duhet te merren per ruajtjen dhe mbrojtjen e gjithe ekosistemeve natyrore perreth ,te biodiversitetit te shendetit e jetes se punonjesve te te kesaj firme ndertuese.

Konkretisht projekti konsiston ne punime dheu, sistemime te tjera, punime betonimi.

TE DHENA TE PERGJITHESHME

Zona ku do te zbatohet projekti eshte zona e bregdetit dhe merr ne konsiderate zonat e mbrojtura e ato publike, arkeologjike, monumentet e natyres, monumentet e kultures, zonat e mbrojtura e çdo zone tjeter qe mund te bjeri ndesh me legjislacionin mjedisor.



Subjekti zbatues duhet të marrë në mbrojtje gjithë mjediset natyrore duke patur parasysh gjithë faktorët ekologjik të zonës së bregdetit si dhe gjithë treguesit klimatik të rrethit të Vlores e të Sarandes.

Kjo analizë e evidenton raportin në studim me territorin përreth, efektet që vijnë nga "influenca territoriale", natyrore si: fiziografia, hidrografia (burimet apo sipërfaqet ujore), karakteristika të veçanta gjeologjike, klimatike (të lidhura me relievin dhe kushte speciale), zona me vlera të veçanta natyrore dhe artificiale si p.sh infrastruktura të rendesise rajonale e kombetare, afersia me qytete apo vendbanime të tjera, një të rendesishme transportuale etj.

Te dhena klimatike

Klima e bregdetit, i cili ben pjesë në Rrethin e Vlores, është tipike mesdhetare malore. Tiparet e saj janë dimri i butë me lagështi, kurse vera e thatë dhe e nxehtë. Temperatura mesatare vjetore është 17° Celsius. Në muajt me të ftohtë temperatura mesatare shënon 6°-8° Celsius, ndërsa në muajt me të nxehtë 25°-26° Celsius. Temperaturat me të uleta lekunden nga 0° deri në -3° Celsius. Sasia reshjeve të shiut shkon nga 1800 – 2200 mm në vit. Pjesa më e madhe në Vjeshtë e në Dimër por, nuk mungojnë reshjet dhe në Pranverë, madje dhe në Verë me reshje të paketa. Klima është e pershtatshme për kultivimin e agrumeve. Numri i përgjithshëm i ditëve me diell lëviz nga 270 deri në 300 në vit.

Ererat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në rrethin e Vlores dhe ndikojnë dhe në klimën e zonës janë: murlani i cili ndihet në periudhën e dimrit, ka shpejtesinë të madhe dhe sjell dy lloje moti si të ftohtë dhe të kthjellët, edhe të ftohtë e me shira (njihet me emrin veriu për shkak të drejtimit sidomos nga veriu dhe verilindja); shiroku quhet ndryshe edhe "era e deteve", ndihet në vjeshtë dhe në fund të dimrit, ka drejtimin jugjuglindje, është erë e ftohtë, dhe e stuhishme dhe sjell ajër të lagët, vranësira dhe reshje; puhia, e cila ndihet kryesisht në verë në formën e një fllad i të lehtë, fryn në drejtimin veri--perëndimor (gjatë ditës ka drejtimin nga deti në tokë dhe gjatë natës ka drejtimin nga toka në det). Krijohet për shkak të kontrastit termik që krijohet si rezultat i ngrohjes dhe i ftohjes së ujit dhe tokës; juga e cila fryn në drejtim të jugut. Në dimër dhe vjeshtë është e lagët, ndërsa në pranverë, është e ngrohtë dhe e thatë.

Gjithë makineritë, mjetet e punës që do të përdoren në këto firme të ndërtimit, janë të siguruar nga importi dhe përfaqësojnë një teknologji shumë të thjeshtë, e të përhapur në gjithë vendin tone në fushën e ndërtimit.

TE DHENA MBI POZICIONIN GJEOGRAFIK TË OBJEKTIT QË DO TË NDËRTOHET

Pozita gjeografike dhe karakteristikat kryesore të territorit që po studiohet, problematika rajonale.

Zona studimore ben pjesë në krahinën kodrinore "Bregdet". Kuota mesatare e sheshit është 189 m mbi nivelin e detit. Sheshi, i ndërtimit ka një përqendrim nga 1.3 % deri në 22 %, disa zona ndodhen në kufi me rrugën kryesore dhe është vendosur në kuotë 2 m mbi të veri e cila bie lehtësisht drejt jugut deri sa arrijnë kuotë të njejtë.

Terreni kontinental ku operon dhe do të operojë edhe në të ardhmen kjo firmë, përfaqëson një ekosistem me florë e dominuar nga bimë barishtore të eger e në gjendje spontane të llojeve të ndryshme, nga bimë të kultivuara druësh frutore si dhe nga bimë dekorative, lule të llojeve të ndryshme, pra përfaqëson florën e vetë qytetit të Vlores si dhe të asaj periferike të qytetit.

Fauna tokësore përfaqësohet nga lloje të ndryshme të klasës së shpendeve në numër të vogël, si dhe nga lloje të invertebrorëve në popullata shumë të vogla e të parrëndesishme, gjithashtu ka edhe lloje të kafshëve të ndryshme shtëpijake që në përgjithësi përfaqësojnë faunën e Vlores.

Ekosistemi ku do të ushtrojnë veprimtarinë ndërtuese kjo firmë, karakterizohet nga faktorë ekologjike abiotike fizike në parametra optimale për jetën e florës dhe faunës përreth si dhe për vetë jetën e popullatës së njerezve që banojnë në këto zone.

Faktoret ekologjike abiotike kimik O₂, CO₂, NO_x, SO₂, N₂ janë në parametra optimale e të favorshëm për jetën e gjallesave dhe të vetë njerezve.

TE DHENA MBI LLOJET E EKOSISTEMEVE QE LIDHEN ME OBJEKTET E FIRMES, FLORA DHE FAUNA

Zona ku do të zbatohet projekti përfshihet në një ekosistem me popullime floristike relativisht të pasur e të përkrahur me sipërfaqe, faunë relativisht të varfër dhe faktore ekologjike abiotike të përkrahur me sipërfaqe.

Veprimtaria ndërtuese e kësaj firme nuk demton ekosistemet përreth, nuk shkakton demtim të floras dhe faunës përreth e gjithashtu nuk ka asnjë lloj demtimi të floras dhe faunës kontinentale në gjithë zonën e gjere dhe sado larg saj. Nuk ka ndikim në treguesit kimiko-fizik të ujërave pasi në procesin teknologjik që përdoret në ndërtim nga kjo firmë nuk ka asnjë lloj të përpunimit me ujë, pra nuk ka asnjë lloj shkarkimesh ujore me përjashtim të atyre që përdoren si përzieresa.

Firma ndërtuese nuk do të kryejë veprimtarinë e vetë në zonë bregdetare të mbrojtur e të shpallur me vendim qeverie, as në plazhe e vende të tjera të mbrojtura.

Gjendja Ekzistuese

Zona ku parashikohet të zbatohet projekti është një zonë me ndërtim të pakta e të pa dendura. Ndërtim të bera para viteve 90. Pronesia është e Bashkisë Himare.

Infrastruktura Rrugore

Objekti përkrahet nga rrugë kembësore dhe auto si dhe terrene të thyera. Aktualisht kjo zonë është me pak ndërtim të hershëm dhe një mjedis natyror bregdetar.

Rjeti inxhijerik

Zona ekzistuese është e lidhur me rjetin ekzistues të kanalizimeve, por duhen ndërtuar një rrjet që të gjitha shkarkimet që derdhen neper gropat septike të banesave.

Rjeti elektrik

Burimi i furnizimit me energji elektrike është në gjendje me të mirë Paralel me rrugën kalon kabli elektrik nëntokësor 20 kv. I cili ndodhet larg vijës së ndërtimit 10m. Në pjesën Jugore kalon një kabl elektrik 6 kv i cili ndodhet nga objekti që do të ndërtohet 4m larg .

Rjeti ujesjelles

Zona furnizohet me ujë të pishëm dhe gjatë ndërtimit do të bëhet ristrukturimi i rjetit sipas një projekti që është në financim .

Gjelberimi

Zona në fjalë është e gjelberuar në mënyrë fizike natyrore akoma dhe në vendet e abandonuara hera herës ekzistojnë tipe bimesh të ulta. Studimi do të shtojë sipërfaqet e gjelberta në proporcion me ndërtimin që do të zhvillohet.

KRITERET E PROJEKTIMIT

Studimi për zhvillimin e këtij projekti, është mbështetur në studimin e përgjithshëm urbanistik të zonës ku respektohen të gjitha normativat e studimit të zonës si dhe specifikohet në detaje studimi pjesor duke e përmirësuar atë dhe realizuar projektin e me sipërfaqe. Është respektuar vija e ndërtimit e planifikuar në studimin pjesor urbanistik të miratuar. Ndërtimi do të jetë tradicional me teknologji bashkëkohore, fasada e re do të jetë në harmoni me objektet tjera përreth zonës të ndërtuara apo në strategji për ndërtim.

Gjate kohes se ndertimit, neper rruget kryesore , neper rrugicat e zones dhe neper sheshet e ndertimit do te levizin mjete te renda me ngarkesa te ndryshme qe do te perbejne shkak per demtimin e tyre dhe ne pergjithesi demtimin e infrastruktures egzistuese. Gjithashtu egziston mundesia qe materjale te ndryshme te bien nga automjetet e transportit dhe te perbejne keshtu ndotje per teritorin e zones e me gjere.

KERKESAT PER PERDORIMIN E TOKES

Nga pikepamja gjeomorfologjike zona e ne fjale ndodhet zonen bregdetare me lartesi maksimale ~231 m dhe minimale ~131 m.

Nga pikepamja gjeologjike zona ze vend ne zonen strukturalo-faciale te Ultesires Panadriatike. Pas perfundimit te objekteve te ndertuara qe nga fillimi do te hiqen te gjitha mbeturinat materjale dhe do te transportohen per ne vendet e caktuara nga pushteti vendor. Mbetjet qe jane demtuese te mjedisit sidomos te bimesise sic jane gelqerja, llaci, çimentoja etj do te pastrohen me kujdes nga e gjithë siperfaqja e sheshit te ndertimit dhe do te transportohen per ne vendin e grumbullimit te caktuar nga pushteti vendor. Gjate ndertimit nuk do te kete shkarkime te lengeta e te demshme qe mund te filtrojne ne toke dhe te behen ndotes te ujrave nentokesore. Gjate kohes se shfrytezimit te objekteve nuk krijohen demtime te tokes, pasi nuk ka mbetje te demshme qe mund te shkarkohen ne te, por jane vetem mbetje te zakonshme urbane. Do te behet nga firma sistemimi i territorit sipas projektit te paraqitur duke respektuar siperfaqet e gjelberuara. Do te percaktohet vendi per vendosjen e kontenjereve per mbetjet urbane te banoreve te ketyre banesave.

TE DHENA PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS

Keto te dhena jane per dy faza te ndertimit te objekteve:

- 1- Gjate ndertimit te objekteve
- 2- Gjate shfrytezimit te objekteve

Problemet qe duhen shqyrtuar dhe analizuar ne lidhje me mbrojtjen e mjedisit:

Gjate ndertimit te objekteve:

- Zgjedhja e projektit ne pershtatje me ligjin per urbanistiken
- Krijimi i kantjerit te ndertimit dhe rrethimi i tij
- Largimi dhe sistemimi i dherave te nxjerra nga germimet
- Sigurimi i ujit dhe energjise elektrike te nevojshme
- Organizimi i pergatitjes se llaçit dhe betonit
- Demtimi i rrugeve dhe shesheve te zones dhe masat e parashikuara per rekuperimin e tij.
- Ndotjet e rrugeve dhe rrugicave te zones gjate transportimit te materjaleve ndertimore dhe masat e parashikuara per parandalimin e tyre
- Mbrojtja e kalimtareve nga aksidentimet e mundeshme gjate fazes se ndertimit etj.
- Mbrojtja e banoreve rreth e qark kantjerit te ndertimit nga zhurmat e tjera te mundeshme.
- Derdhja e ujrave te bardha e te zeza qe do te dalin gjata fazes se ndertimit te objektit.

Gjate shfrytezimit te objekteve:

- Parkimi i automjeteve te klienteve
- Sigurimi i ujit
- Furnizimi me energji elektrike
- Shkarkimet e ujrave te bardhe dhe te zeza
- Ndertimi i rrugeve dhe shesheve

- Gjëlberimi i teritorit brenda dhe rreth e qark objektit
- Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve te ngura urbane
- Termoizolimi i murreve
- Perdorimi i energjise diellore

NDIKIMET NE MJEDIS

NDIKIMET NE UJRAT SIPERFAQSORE

Sic permendet me siper gjendja ekzistuese nga ndertimet kaotike qe jane ndertuar krijon nje ambient te ndotur dhe ne mjaftte vende ku ka grumbullime apo gropezime ujrato flen ne siperfaqe dhe krijojen ambient te ndotur. Studimi Urbanistik do te sitemoi rjedhjen e ujrave siperfaqore duke i drejtuar ato drejt shimblethesave te rrugeve dhe lulishteve te cilat kalojne ne rjetin inxhinjerik te sistemit. Duke parashikuar nje zone te gjelberuar te konsiderueshme ku furnizimi me uje nuk do te mungoje do te kemi nje regullim te ekosistemit. Ujrat siperfaqore duke qarkulluar nuk do te krijojne ndotje te ambientit veç gjallerimin e tij me bimesite te cilat kerkojne uje dhe ajer .

NDIKIMET NE UJRAT NENTOKESORE

Ujrat nentokesore ne kete zone sic u permende dhe me larte gjenden nen nivelin 10.0 m dhe i perkasin ujrave freatik ato jane te embla dhe nuke permbajne ndotje kimike. Ujrat nentokesore do te takohen gjate germimeve te objektit i cili eshte projektuar me parkim nentokesore. Keto ujra gjate ndertimit do te largohen me pompa dhe me ndertimin e kateve te nendheshme qofte garazhe qofte destinacione te tjera keto ambiente do te parshikohen me hidroizolime duke eleminuar lageshtine e nenkatit te nedheshem. Pra zgjidhjet teknike te tanishme evitojne plotesisht rjedhjen e ujrave nentokesore ne ambientet e nedheshme.

MATRICA E NDIKIMEVE NEGATIVE NE UJRAT RRJEDHESE(JO STANTANTE)NENTOKESORE

Faza e projektit	Ndikime klimatike	Ndikime nga hidrokarburet	Ndikime nga materialet organike
Para ndertimit	+++	-	-
Gjate ndertimit	++	-	++
Pas ndertimit	-	-	-

“ -“ nuk ka ndikim

“++’ ka ndikim te paket

“+++” ka ndikim te konsiderueshem

NDIKIMET NE TOKE

Per realizimin e studimit ne objekt faza me e veshtire eshte ajo e germimit dhe konkretisht ne objektet e larta ku germimi behet ne forme katllavani. Ne kete rast ndikimet ne mjedis per efekt te ndertimeve gjithmon do te ndodhin, por keto ndikime firma zbatuese ka tendencen qe ti zvogeloje sa me shume. Per kete ne zonen ndertimore behet rrethimi me llamarina dhe makinerite qe do te ngarkojne dherat duhet te shkelin mbi derrasa te pasterta qe te mos behen gomate me balte. Dherat e germuara do te hidhen ne vende te caktuara nga Bashkia jashte teritorit te qytetit apo ne vende ku qyteti ka nevojte per mbushje. Ujrat do te hiqen me pompa dhe shkarkimet do te behen ne pusetat e rrugeve.

AKTIVIZIMI I EROZIONIT

Mendohet se ekuilibri aktual i tokes do te priset ne menyre rrenjesore gjate zbatimit te projektit, Gjate germimeve gjithmon ne faqet e gropave krijohen rafshe reshqitjeje qe ne te gjitha rastet meren masa mbrojtje kunder reshqitjeve te dheut.

Ne thellesite deri ne 3 m perdoren palangola te ngulura dhe ne rastet anes rrugeve keto zevendesohen me shpime e betonimin e pilotave. Ne distanca qe nuk lejone shembjen e dherave.

MATRICAT PERMBLEDHESE TE NDIKIMEVE TE MJEDISIT

Keto matrica jane ngritur mbi bazen e seleksionimit te ndikimeve me te rendesishme duke patur parasysh te gjitha fazat e projektit dhe jane grupuar ne dy matrica baze (te permbledhura) qe japin respektivisht ndikimet negative dhe pozitive .

	Para projektit	Gjate zbatimit	Rehabilitimit
Ujrat siperfaqesore	++	++	-
Ujrat nentokesore	-	+++	-
Toke	-	+++	-
Biodiversiteti	-	+++	-
Ekonomike	+++	-	-
Infrastruktura	+++	++	-
Shendet/higjene	+++	++	-
Ajer	+++	++	-

Matrica permbledhese e ndikimeve negative me te rendesishme

- "-" Nuk ka ndikime negative
- "-+" Ka te ngjare te kete ndikime negative te vogla
- "++" Ka ndikime relative
- "+++ " Ka ndikime te medha

	Para projektit	Zbatimi	Rehabilitimit
Ujrat siperfaqesore	-	-	+++
Ujrat nentokesore	-	-	+++
Toke	-	-	-
Biodiversiteti	-	-	++
Ekonomike	-+	+++	+++
Infrastruktura	-	+	+++
Shendet/higjene	-	-+	+++
Ajer	-	-	++

Matrica permbledhese e ndikimeve pozitive me te rendesishme

- "-" Nuk ka ndikime pozitive
- "-+" Ka te ngjare te kete ndikime pozitive te vogla
- "++" Ka ndikime relative
- "+++ " Ka ndikime te medha

Ne baze te ketyre matricave permbledhese eshte ngritur edhe plani i zbutjesve te efekteve negative dhe ai i nxitjes se atyre pozitive si mbas zbatimit te projektit.

REHABILITIMI I TOKES DHE TERITORIT TE STUDIMIT PJESOR URBANISTIK

Mbarimi i ndertimeve nuk presupozon se ka perfunduar objekti dhe duhet dorezuar. Kryesorja eshte sistemimi i teritorit konform planit te studiuar urbanistik. Kjo eshte dhe faza me e rendesishme e nje zone apo qendre te banuar. Per kete veç fondet per sitemim te ambienteve perreth objekteve te banimit do te planifikohen fonde dhe per sistemimin e rrugeve, siperfaqeve te gjelberuara ndriçimin e tij.

MONITORIMI

Me perfundimin e gjithë ndertimit, ndertimin e rrugeve, lulishteve ndricimin e tyre nje rendesi te vecante ka dhe monitorimi dhe mirmbajtja e ambientit per kete vihen ne eficence gjithë strukturat si ndermarjet e mirmbajtjes se rrugeve, gjelberimi, pastrimi e popullata qe jeton ne zonen e studimit sa me te kujdeshem te jemi aqe me i shendetshem eshte ambienti ku ne jetojme.

PERFUNDIME

Bazuar ne normat e lejueshme te percaktuara nga ligjet perkatese mbi ndikimet ne mjedis, subjekti qe do te zhvilloje aktivitetin e ndertimit te objekteve te ndryshme dhe qe eshte paraqitur prane A.R.M.-se Vlore per te marre **Pelqim Mjedisor** nuk shkakton ndotje te mjedisit, pra nuk shkakton:

- Ndotje te ujit te pishem;
- Ndotje te ujrave siperfaqesore, ose te atyre nentoksore;
- Ndotje te ajrit;
- Ndotje te tokes.

Firma dhe veprimtaria e saj:

- Nuk demton ekosisteme
- Nuk demton burimet natyrore
- Nuk demtohen zhvillimet social-kulturore te zones apo te Bashkise Himare ku do te ushtroje veprimtarine e vete firma ndertuese.

Pergatiten Raportin
Inxhinjer Mjedisi Drilona Topi